



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 59 Prot

Datë 15/01 /2015

VENDIM

Nr. 01 datë 15.01 .2015

Në mbështetje të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*".

VËREJ SE:

Në zbatim të urdhrit nr. 217 datë 01/12/2014, është ushtruar inspektim administrativ pranë kontrolluesit, Urdhri i Mjekëve Shqiptarë, me objekt; *Verifikimi i zbatimit të Rekomandimit nr. 27 prot, datë 11/04/2014, të zyrës së Komisionerit*, dhënë ndaj këtij kontrolluesi.

Kontrolluesi Urdhri i Mjekëve Shqiptarë, nëpërmjet Rekomandimit nr. 27 prot, datë 11/04/2014, të zyrës së Komisionerit, detyrohet që;

Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të bëjë informimin e subjekteve të të dhënave personale, që plotësojnë formularët e "*regjistrimit*", "*vetëdeklarimit*" dhe "*aplikimit*", mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim, përhapjen e të dhënave personale dhe sigurinë e tyre.

Në faqen zyrtare të internetit www.urdhrimjেকেve.org.al, të publikohen në një rubrikë të veçantë "*politikat e privatësisë*", me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale.

Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Urdhri i Mjekëve Shqiptarë, të hartojë rregullore të brendshme, lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë, konfidencialitetin e të dhënave personale.

Të përcaktojë aksesin e personave përgjegjës, mbi dokumentat që lidhen me informacionin, të dhënat personale që mblidhen për mjekët, stomatologët, anëtarë të Urdhrit të Mjekëve, të cilat mbahen në regjistra dhe dosje të veçanta.

Sipas Rekomandimit kontrolluesi duhet të realizojë këto detyrime brenda një afati kohor prej 45 (*dyzet e pesë*) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni për Rekomandimin.

Nga inspektimi administrativ i kryer rezultoi se; kontrolluesi Urdhri i Mjekëve Shqiptarë, nuk ka plotësuar detyrimin që mbart Rekomandimi nr. 27 prot, datë 11/04/2014, i zyrës së Komisionerit. Ky fakt provohet nga pohimet e përfaqësuesit të kontrolluesit, investigimet e kryera gjatë inspektimit administrativ, procesverbalit i inspektimit administrativ dhe provat e administruara.

Në zbatim të neneve 93-96 të ligjit 8485 datë 12/03/1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, më datën 29/12/2014 u zhvillua seanca dëgjimore me përfaqësuesit me autorizim të kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të inspektimit administrativ.

Përfaqësuesi i kontrolluesit, në seancë dëgjimore parashtroi me shkrim faktin se kontrolluesi Urdhri i Mjekëve Shqiptarë, nuk ka plotësuar detyrimet që mbart Rekomandimi nr. 27 prot, datë 11/04/2014, i zyrës së Komisionerit, por në kuadër të zbatimit të tyre po merren masa dhe janë ngritur grupe pune për hartimin e akteve nënligjore sipas Rekomandimit të dhënë nga Komisioneri.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se; shkeljet ligjore të kryera nga kontrolluesi, të cilat lidhen me detyrimin për informim të subjekteve të të dhënave personale, gjatë procesit të mbledhjes së këtyre të dhënave, nëpërmjet formularëve të “regjistrimit”, “vetëdeklarimit”, “aplikimit”, si dhe mos publikimi i rubrikës “politikat e privatësisë”, në faqen e internetit www.urdhrimjেকেve.org.al, kanë të bëjë me mos zbatimin e nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Sipas përcaktimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga ky nen, kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t’i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit etj. Kur kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare. Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënies së të dhënave personale.

Informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtëm të respektimit të privatësisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më i shpejtë që të jetë e mundur.

Gjithashtu edhe publikimi i rubrikës “politikat e privatësisë” në faqen e internetit të kontrolluesit ka për qëllim informimin e individëve subjekte të të dhënave personale që aplikojnë online ose personave që vizitojnë/aksesojnë faqen.

Mos realizimi i detyrimit ligjor për informim nga kontrolluesi iu mohon subjekteve të të dhënave personale të drejtën për tu informuar rreth të dhënave që ata deklarojnë pranë kontrolluesit, mbi mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, masat e marra për sigurinë e të dhënave personale, faktin se çfarë bëhet me të dhënat personale të tyre, kush po i përpunon të dhënat personale, ku dhe kujt i përhapen të dhënat e tyre, të drejtat e subjekteve të të dhënave personale dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Shkeljet ligjore të bërë nga kontrolluesi Urdhri i Mjekëve Shqiptarë, të cilat lidhen me mungesën e rregullores për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë, konfidencialitetin e të dhënave personale, përcaktimin e aksesit të personave përgjegjës, mbi dokumentat dhe të dhënat personale që mblidhen për mjekët, stomatologët, anëtarë të Urdhrit të Mjekëve, janë shkelje që lidhen me mos zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga nenet 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Mungesa e rregullave dhe e hartimit të rregullores së veçantë, në të cilën të jenë shprehur përcaktimet e neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, dhe akteve të Komisionerit, tregojnë për mungesën e masave të sigurisë dhe shkallës së ulët të konfidencialitetit që ka kontrolluesi në procesin e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale.

Komisioneri vlerëson se mospërbushja në kohë e Rekomandimit nr. 27 prot, datë 11/04/2014, të zyrës së Komisionerit, e ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative, sipas nenin 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, bazuar në nenin 39, pika l/b, të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë.

Për këtë shkelje kontrolluesi dënohet me gjobë 10 000 lekë.

- Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, bazuar në nenin 39, pika l/dh, të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 150 000 lekë.

Për këtë shkelje kontrolluesi dënohet me gjobë 10 000 lekë.

Gjithashtu në pikën 2 të nenit 39 është parashikuar se “*Personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.*”

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes së kontrolluesit me detyrimet që rrjedhin për zbatimin e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, mospërbushjen në kohë të detyrimit që mbart Rekomandimi i Komisionerit dhe masat reaguese të kontrolluesit për zbatimin e Rekomandimit.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 27, 28, 29, 30/2, 32, 39/1/b/dh, 40 e 41, të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit **Urdhri i Mjekëve Shqiptarë** me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 18** të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit **Urdhri i Mjekëve Shqiptarë** me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në **nenet 27, 28** të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

